

Njoftim i përqendrimit me të cilin SALUS, Tregtia me shumicë, d.o.o. Slloveni do të fitoj kontrollin mbi tregtinë, prodhimin dhe shërbimet FARMADENT d.o.o. Slloveni

(lënda nr. 08-89/2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 05.07.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin SALUS, Tregtia me shumicë, d.o.o. rruga Litostrojska 46A, 1000 Lubjanë, Slloveni merr kontrollin e vetëm mbi tregtinë, prodhimin dhe shërbimet FARMADENT d.o.o. rruga Minazhikova nr. 6, Maribor, Slloveni.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

SALUS, Tregtia me shumicë, d.o.o. (Salus) është një ndërmarrje-bijë në pronësi të plotë të SALUS, Lubjanë, d.d. e cila është shoqëria mëmë e grupit të shoqërive Salus ("Grupi Salus "). Grupi Salus gjeneron shumicën e të ardhurave të tij përmes ndërmarrjeve-bijë të tij SALUS, tregtia me shumicë d.o.o. ("SALUS tregtia me shumicë") dhe Sanolejbor d.d. ("Sanolejbor"), aktiviteti kryesor i të cilit është tregtia me shumicë (Salus dhe Sanolejbor) dhe tregtia me pakicë (Sanolejbor) me barna, produkte farmaceutike, ndihma mjekësore, pajisje dhe materiale mjekësore. Shoqëritë brenda Grupit Salus ofrojnë gjithashtu shërbime magazinimi, rregullatorë, shërbime farmakovigjilence, marketing dhe promovim farmaceutik, farmakoekonomi.

Në Maqedoninë e Veriut, Grupi Salus është aktiv përmes ndërmarrjes- bijë Carso Pharm, shpknjp lindenit, e cila është aktive në përfaqësimin dhe tregtimin e markave tregtare të prodhuesve kryesorë të produkteve farmaceutike.

Tregtia, prodhimi dhe shërbimet **Farmadent** d.o.o. (Farmadent) është aktive në tregtinë me shumicë, kryesisht tregtimin e ilaçeve për njerëzit, por edhe shitjen e produkteve të tjera të kujdesit shëndetësor dhe mirëqenies si ato të listuara më sipër për Salus (me përjashtim të pajisjeve mjekësore). Farmadent ka një ndërmarrje- bijë në pronësi të plotë, GoFarm d.o.o. e cila është shitës me shumicë në zonat e sipërpërmendura.

Farmadent dhe GoFarm d.o.o. nuk janë aktive në Maqedoninë e Veriut. Ato nuk kanë asnjë pronë dhe nuk kanë bërë asnjë qarkullim në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022.

Sipas parashtresit të njoftimit si treg relevant për vlerësimin e përqendrimit në fjalë mund të për caktohen tregjet e mëposhtme: tregu me shumicë i barnave të mjekësisë humane, tregu me shumicë i mjekësisë veterinarë, tregu me shumicë i pajisjeve mjekësore dhe tregu me shumicë i produkteve të tjera (suplemente dietike, produkte kozmetike, ushqime, etj.).

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen

edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

21.06. 2023